



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE**

Nr _____ prot

Elbasan më ____/____2025

Lenda : Dërgim Specifikime teknike për mallin : " *Blerje materiale ndertimi + inerte* " .

**DREJTORISE PROKURIMEVE PUBLIKE
BASHKIA ELBASAN**

Agjencinë e Shërbimeve Publike Elbasan po ju dërgon Specifikimet teknike për mallin :
" **Blerje materiale ndertimi + inerte** " .

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Materialët

Përbërësit duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Përbërësit nuk duhet të përmbajnë depozitime të materialeve të dëmshme organike si p.sh.barishte, drunjë ose materiale të ngjashme. Përbërësit që mund të kenë një potencial për reaksione alkaline duhet të vlerësohen me kujdes dhe nëse ka rrezik potencial për një reaksion alkaline, inxhinieri duhet të marrë një vendim të qartë dhe përfundimtar mbi përshtatshmërinë e përbërësve.

1. Çimento

Çimento duhet të jetë në përputhje me kushtet e STASH 501-87, 503-87. Kontraktori do të pajisë çdo ngarkesë të çimentos me një kopje të faturës që deklaron sasinë e dorëzuar, emrin e prodhuesit dhe çertifikatën e prodhuesit e cila tregon për çdo ngarkesë çimentoje provat laboratorike dhe analizat e bëra në përputhje me standartet.

Çimento duhet të dorëzohet në paketa orgjinale të shënuara, të padëmtuara, direkt nga fabrika dhe të ruajtura në kushtet e duhura në nje depo të përshtatshme dhe të ajrosur.

2. Rëra

Rëra duhet të plotësojë kërkesat e standartit shqiptar STASH 538-87.

3. Granil

Granili duhet të plotësojë kërkesat e standartit shqiptar STASH -512-78 ose në përputhje me Eurokodet.

4. Hekur ndërtimi

Hekuri i ndërtimit duhet të jetë Çelik i markës FeB 44 K ,diametri i hekurit do të jete nga (Ø 6 mm – Ø12 mm). Provat e çelikut do të bëhen në përputhje me Eurokodet. Kontraktori do të pajisë çdo ngarkesë të hekurit me nje kopje të faturës që deklaron sasinë e dorëzuar, emrin e prodhuesit dhe çertifikatën e prodhuesit e cila tregon për çdo ngarkesë hekuri provat dhe analizat e bëra në përputhje me standartet.

5. Rrjeta e telit për gabiona

Rjeta e telit për gabjona duhet të jetë e prodhuar në fabrikë. Diametri i telit të gabjonit do të jetë Ø2 mm xingato. Gjerësia e rrjetës të jetë 1.2 m ,diametri i brimave të rrjetës të jetë jo me shumë se 6 cm.

6. Dërrasë pishe 5*10 cm

Dërrasat duhet te jene të skuadruara pa plasaritje.Sasia e mallit të shoqërohet me fletën e cilësise së mallit.

7. Tubacionet e brinjezuara

Tubacionet e brinjezuara Ø-300, Ø-400, Ø-500, Ø-600 të jenë të shoqëruara me çertifikate cilësie të lëshuar nga laboratorët e licensuar për materialet plastike.

8. Tubacionet e betonit dhe B/A


Tubacionet e betonit Ø-400, Ø-600, Ø-800, Ø-1000 të jenë të shoqëruara me çertifikate cilësie të lëshuar nga laboratorët e licensuar për materialet e ndërtimit.

Tubat Ø -600, Ø-800, Ø-1000 duhet të jenë me zgarë hekuri .

9. Bbloqet e betonit (1*1*1)m

Bbloqet e betonit duhet të jenë të markës C16/20 (të vërtetuara me certificate cilësie të lëshuar nga laboratorët e licensuar për materialet e ndërtimit). Bbloqet duhet të jenë me përmasa (1x1x1) m, me forma të rregullta këndrejtë. Ganxha e montimit me diametër Ø16 mm dhe gjatësi L=152 cm duhet të jetë e montuar sipas skicës së poshtëtreguar.

BLLOK BETONI



SHENIM :

1. GJATE ZBATIMIT TE PUNIMEVE PRURJA TE JETE NE MINIMUM
2. BLOQET E BETONIT TE JENE ME GANXHE Ø16 DHE LIDHJA E TYRE TE BEHET ME SHUFRA Ø 10 mm NE FORME SHAHU

10. Gëlqere e shuar (qull)

Gëlqerja e shuar (qull) duhet të jetë e cilësisë së mirë dhe të jetë e ambalazhuar në thasë plasmasi me peshë 10 kg.

11.Kripa e Gurit

Kripa e gurit duhet të jetë e paketuar për shkrijen e akullit dhe borës gjatë periudhës dimërore në rrugët me asfalt. Kripa e gurit duhet të jetë e paketuar në masë 50 kg.

12.Rrjete hijezuese

Tekstil I prodhuar nga filamente PP (polipropileni). Rezistent, poroz dhe I qendrueshem ndaj agjenteve atmosferik he rrezatimi UV. Perforecimi I struktures se tekstilit shtrihet cdo 15 cm. Tekstili instalohet thjeshte. Mund te perdoret ne cdo terren.

Konceptoi:

P/Sek Teknik: Alessandro Abdiaj

MIRATOI
DREJTORI PERGJITHSHEM ASHPR
Altin CENOLLI